

## MARREVESHJE PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE

KJO MARREVESHJE PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE eshte lidhur me date 26.11.2021 ("Marreveshja"):

- Z. **Enkelejdi Joti**, lindur me 11/10/1969, ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me numer 034049622 dhe nr. Personal G91011029U, (referuar ne vijim si "**Shitesi i Pare**"),

dhe

- Z. **Agron Shaplo**, lindur me 20.04.1953 ne Tirane, Shqiperi, banues ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me numer 036073933 dhe nr. Personal F30420145K (referuar ne vijim si "**Bleresi**"),

Bleresi dhe Shitesi do te referohen bashkerisht si "**Palet**" dhe secila prej tyre do te referohen si "**Pale**".

### **NDERSA:**

- A. Shitesi eshte zoterues i 5798,5200 aksioneve te cilat perfaqesojne 2,52% te kapitalit te shoqerise "**DIGIT-ALB**" **SH.A.**, nje person juridik Shqiptar i themeluar dhe i organizuar ne formen e nje shoqerie aksionare, te regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me numer regjistrimi NUIS: K41719004D ("**Shoqeria**");
- B. Shitesi synon te shese te gjitha Aksionet e tij, qe perfaqesojne te gjithe pjesemarrjen e tij ne kapitalin e Shoqerise (ne vijim "**Aksionet**") Bleresit dhe Bleresi synon te bleje Aksionet nga Shitesi ne perputhje me termat dhe kushtet e kesaj Marreveshje;
- C. Shitesi dhe Bleresi kane lidhur nje Marreveshje te Shitjes dhe Blerjes me 23.11.2021 ("**Marreveshja Kryesore**") per shitjen dhe blerjen e Aksioneve;
- D. Te gjitha kushtet paraprake dhe kerkesat sic percaktohen ne Nenet 2, 3, 4 te Marreveshjes Kryesore jane permbushur dhe nuk ekziston asnje pengese ligjore per lidhjen e kesaj Marreveshje si dhe per transferimin e Aksioneve;
- E. Palet konfirmojne dhe pranojne perfaqesimet dhe garancite e parashikuara ne piken 6 te Marreveshjes Kryesore qe nga dita e kesaj Marreveshje jane ende te vlefshme dhe te sakta;

**PRANDAJ ESHTE RENE DAKORD** si me poshte:

### **1. TRANSFERIMI I AKSIONEVE**

- 1.1 Qe nga data e kesaj Marreveshje, Shitesi shet dhe transferon tek Bleresi, dhe nga ana tjetere Bleresi blen dhe merr nga Shitesi, titullin e pronesise se Aksioneve si dhe te gjitha te drejtat e lidhur me Aksionet sipas termave dhe kushteve te percaktuara ne Marreveshjen Kryesore.
- 1.2 Per transferimin e Aksioneve sipas paragrafit 1.1 me siper, Bleresi i ka paguar Shitesit Çmimin e Blerjes ne shumen dhe sipas menyrave te rena dakord ne Marreveshjen Kryesore.



## 2. DISPOZITAT E ZBATUESHME

- 2.1 Kjo Marreveshje se bashku me Marreveshjen Kryesore perbejne marreveshjen midis Paleve dhe te gjitha dispozitat e Marreveshjes Kryesore zbatohen plotesisht edhe per kete Marreveshje.
- 2.2 Palet bien dakord dhe konfirmojne qe ne daten e kesaj Marreveshjeje, te gjitha kushtet paraprake dhe kerkesat sic percaktohen ne Nenet 2, 3, 4 te Marreveshjes Kryesore jane permbushur dhe se nuk ekziston asnje pengese ligjore per lidhjen e kesaj Marreveshje si dhe per transferimin e titullit te pronesise se Aksioneve.

## 3. REGJISTRIMI

- 3.1 Duke nisur qe nga data e nenshkrimit te kesaj Marreveshje, Bleresi fiton pronesine e Aksioneve dhe ne cilesine e pronarit te Aksioneve gezon te drejten te siguroje regjistrimin e nje transferimi te tille ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne Qendren e Regjistrimit te Aksioneve.


## 4. KOPJET E NJEJTA

Kjo Marreveshje mund te nenshkruset ne disa numer kopjesh, secila prej te cilave kur nenshkruset dhe dorezohet do te perbeje nje origjinal. Te gjitha kopjet se bashku do te perbejne te njejtin instrument.

**NE DESHMI TE SA ME SIPER** Palet vendosen nenshkrimet e tyre si me poshte:

Per Shitesin:

**Enkelejdi Joti**



Per Bleresin:

**Agron Shapllio**

